



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA ROSKOVEC

KRYETARI

Nr. 1556 Prot.

Roskovec, më 28.02.2026

VENDIM

Nr. 19, Datë 28.02.2026

PËR

MIRATIMIN E PLANIT VJETOR TË PRANIMEVE NË SHËRBIM CIVIL, PËR VITIN 2026

Në mbështetje të Ligjit Nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetqeverisjen vendore, të ndryshuar, neni 64, gërma “j”; Ligjit Nr. 152/2013, date 30.05.2013 “Për Nëpunësin Civil”, të ndryshuar, neni 18 dhe 19; Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 108 datë 26.02.2014 “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”, pika 11 dhe 13; Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 76, datë 23.12.2024 “Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të Bashkisë Roskovec dhe të Ndërmarrjes Vartëse”; Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 71, datë 24.12.2025 “Për miratimin e dokumentit përfundimtar të PBA 2026-2028 dhe buxhetit të vitit 2026”; Vendimit të Kryetarit të Bashkisë Roskovec Nr. 1, datë 06.01.2026 “Për miratimin e strukturës organizative dhe pagat përkatëse për Bashkinë Roskovec dhe Njësitë Administrative Kuman, Kurjan dhe Strum, si dhe organigramës për vitin 2026”, protokolluar në institucionin tonë me Nr. 24, datë 06.01.2026, si dhe Raportit të paraqitur nga Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore Nr. 1555 datë 28.02.2026 “Për planin vjetor të pranimeve në shërbim civil, për vitin 2026”,

V E N D O S A:

- 1- Miratimin e planit vjetor të pranimeve në shërbim civil për vitin 2026 sipas listës së mëposhtme të pozicioneve me kategoritë, klasat dhe grupet përkatëse të administrimit.

Nr.	Pozicioni	Vende vakante	Kategoria-Klasa	Grupi i administrimit
1.	Përgjegjës i Sektorit të Auditit të Brendshëm	1 (një)	III-2	I posaçëm
2.	Specialist i Auditit të Brendshëm	2 (dy)	IV-3	I posaçëm
3.	Përgjegjës i Njesisë së Integritimit European	1 (një)	III-2	I përgjithshëm
4.	Specialist për Shkrimin e Projekteve	2 (dy)	IV-3	I përgjithshëm
5.	Specialist për Zbatimin e Projekteve të Huaja	1 (një)	IV-3	I përgjithshëm
6.	Përgjegjës i Sektorit të Monitorimit dhe Zbatimit të Kontratave	1 (një)	III-2	I përgjithshëm

7.	Specialist për Ndjekjen e Investimeve	1 (një)	IV-3	I posaçëm
8.	Drejtor Ekonomik	1 (një)	II-2	I posaçëm
9.	Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Njerëzore	1 (një)	III-2	I përgjithshëm
10.	Përgjegjës i Sektorit Juridik	1 (një)	III-2	I posaçëm
11.	Specialist Jurist	2 (dy)	IV-3	I posaçëm
12.	Përgjegjës i Sektorit të Sekretari-Arkivit	1 (një)	III-2	I përgjithshëm
13.	Drejtor i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Mjedisit dhe Pronës	1 (një)	II-2	I posaçëm
14.	Përgjegjës i Sektorit të Planifikimit dhe Lejeve të Ndërtimit	1 (një)	III-2	I posaçëm
15.	Specialist Inxhinier/Arkitekt/Dizenjim	1 (një)	IV-3	I posaçëm
16.	Specialist për Lejet e Ndërtimit/Mjedisi	2 (dy)	IV-3	I posaçëm
17.	Specialist për Menaxhim Pronash	2 (dy)	IV-3	I posaçëm
18.	Drejtor i Teknologjisë së Informacionit dhe Zyrës me Një Ndalesë	1 (një)	II-2	I përgjithshëm
19.	Përgjegjës i Sektorit të Teknologjisë së Informacionit (TI) dhe performancës	1 (një)	III-2	I posaçëm
20.	Specialist IT dhe i Statistikave	1 (një)	IV-3	I posaçëm
21.	Drejtor i Politikave Ekonomike dhe Promovimit të Bashkisë	1 (një)	II-2	I përgjithshëm
22.	Specialist për Vullnetarizmin, Rininë dhe Barazinë Gjinore	1 (një)	IV-3	I përgjithshëm
23.	Specialist për Diasporën, Migracionin dhe Turizmin	1 (një)	IV-3	I përgjithshëm
24.	Specialist për Politikën e Strehimit Social	2 (dy)	IV-3	I përgjithshëm
Totali		30 (tridhjetë)	Kategorizimi sipas V.K.M nr.142, datë 12.03.2014 (i ndryshuar)	

- Ngarkohet Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (*Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Juridike dhe Arkivit*) për publikimin e këtij plani në portalin elektronik të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, në faqen zyrtare të institucionit tonë dhe në këndet e publikimeve në Bashkinë Roskovec dhe Njësitë Administrative Kuman, Kurjan dhe Strum.
- Ngarkohet Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (*Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Juridike dhe Arkivit*) të fillojë kryerjen e procedurave të rekrutimit pas publikimit të këtij plani pranimesh.
- Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Majlinda Buri

